



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.09.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1.Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë – Hercegovinës, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

2.Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Mark Frroku, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

1. Ramadan Çaço – drejtor në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
2. Danja Sinanaj – juriste në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
3. Brunilda Paskali - zëvendësministre e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

4. Bashkim Sykja - drejtor i Mbështetjes së Sipërmarrjes, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

5. Arvit Uruçi – përgjegjës i Sektorit të Ligjshmërisë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit, meqenëse kuorumi është i realizuar.

Në rendin e ditës së sotme kemi dy çështje për të shqyrtuar.

Fillojmë së pari me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare””, të ndryshuar.

Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tregtisë, që është ministria inicuese e projektit, është e pranishme për të prezantuar projektin, zonja Brunilda Paskali, zëvendësministre, dhe zoti Bashkim Sykja, drejtor i Mbështetjes së Sipërmarrjes në këtë ministri, së bashku me përgjegjësën e sektorit të Ligjshmërisë, zotin Uruçi.

Fillimisht do të dëgjojmë zonjën Paskali për një paraqitje të përmbledhur të projektit, më pas relatorin dhe pas fjalës së relatorit do të kemi pyetje dhe diskutime. Ndërsa shqyrtimin nen për nen, për t’i dhënë kohë ministrisë të reflektojë mbi disa vërejtje që ne, relatori bashkë me stafin, kemi evidentuar, do ta zhvillojmë javën që vjen.

Fjala për ju, zonja Paskali.

Brunilda Paskali – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë, siç e tha kryetari, sot kemi ardhur të paraqesim një përmbledhje mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare””, të ndryshuar.

Pse iniciohet ky ligj? Ka disa arsye pse Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes vendosi të bëjë disa përmirësime dhe ndryshime.

Së pari, si pjesë e procesit të afrimit të legjislacionit me Bashkimin European, si prioritet afatshkurtër i partneritetit evropian në zbatim të rekomandimeve që dalin nga progres-raportet e fundit të Bashkimit European, në zbatim të Planit Kombëtar të Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, si dhe përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar mbi shoqëritë tregtare.

Neni 50 pikat 1 dhe 3 të MSA-së kërkojnë që Shqipëria dhe Bashkimi European të mundësojnë ngritjen edhe ushtrimin e aktivitetit të shoqërive tregtare, filialeve, degëve dhe personave fizikë nga të dyja palët. Ndërkohë kemi edhe ndryshimet e nevojshme për të afruar më tej ligjin nr. 9901 të vitit 2008 me kërkesat e dy direktivave evropiane 2009/101 dhe 2009/109.

Përafrimi i direktivës 2009/101 synon: bashkërendimin e masave mbrojtëse për interesat e pronarëve dhe mbrojtjen e palëve të treta në një transaksion tregtar, në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare, pasojat e pavlefshmërisë për palët e treta në mirëbesim, si dhe përcaktimin e afateve të parashtrimit të padive përkatëse. Ndërkohë që përafrimi i direktivës 2009/ 101 synon përafrimin në lidhje me kërkesat për raportimin dhe dokumentimin në rastin e bashkimit dhe ndarjes së shoqërive tregtare.

Siç u tha, grupi i punës për hartimin e këtij projektligji është drejtuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ka pasur të përfshirë edhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Ndërkohë dua të theksoj se ky projektligj është hartuar me asistencën e GIZ-it.

Çfarë merr në konsideratë ky projektligj? Kontribuon në përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet rregullimit të pasojave të pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive tregtare duke garantuar siguri për kreditorët e shoqërisë, duke parashikuar 6 raste për prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit mbi gjendjen e aftësisë paguese.

Sipas nenit 1 të ligjit, rastet e parashikuara për përcaktimin e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërive janë disa. Më lejoni, t'i përmend: kur dokumentacioni për regjistrimin fillestar të shoqërisë nuk është hartuar në formë shkresore, kur themeluesit e shoqërisë në datën e themelimit të saj ishin të pazotë apo kur objekti i shoqërisë ndalohet me ligj. Ndërkohë, përmirësimet e sjella në nenin 4 të projektligjit, ndryshimi i propozuar parashikon për shoqëritë aksionare që çdo marrëveshje, e cila kërkon miratim sipas nenit nr. 13 të ligjit 9910, të njoftohet aksionarëve sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 72 orë nga dhënia e miratimit të marrëveshjes përkatëse nga këshilli i administrimit apo këshilli mbikëqyrës. Vendosija e këtij afati kohor prej 72 orësh do të ndikojë pozitivisht në rritjen e transparencës. Ndërkohë sqarohen rastet e abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë dhe të përgjegjësisë në lidhje me to kur vërtetohen me vendim gjyqësor, njësohen të drejtat e minorancës dhe kreditorëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar me ato të parashikuara me shoqëritë aksionare në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të parregullta të administratorëve, përmirëson procedurat për falimentin dhe prishjen e shoqërive. Kështu teksti i ri i nenit numër 43, 99 dhe 137 të ligjit ekzistues synon të zgjidhë problemin që ekziston sipas parashikimit të ligjit të falimentit, në bazë të të cilit, nëse para fillimit të procedurës së falimentit rezulton se masa e falimentit nuk mjafton për mbulimin e shpenzimeve të procedurës, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit e ndërpret procedurën.

Nga praktikat aktuale, në bazë të ligjit të falimentit, ka pasur raste që një shoqëri, e cila nuk ka pasuri të mjaftueshme as për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentit, të mbetet e regjistruar në QKR, pasi ligji i falimentit nuk i njeh gjykatës të drejtën për të urdhëruar çregjistrimin në këto raste. Sipas propozimit të projektligjit, gjykata e falimentit së bashku me vendimin për përfundimin e procedurave të falimentit vendos edhe prishjen e shoqërisë duke e njoftuar QKR-në, e cila çregjistron shoqërinë nga regjistri tregtar pa kryer procedurat e likuidimit.

Gjithashtu, një pikë tjetër është se sqaron ndarjen e kapitalit të shpk-ve sipas numrit të ortakëve dhe të drejtave të votës të lidhura me kuotën. Ky përmirësim në projektligj, reflekton kërkesat e shumë aktorëve njëherësh, si QKR, studiot ligjore, bizneset, për sa u takon politikave të hasura gjatë zbatimit të legjislacionit aktual për shoqëritë tregtare. Më konkretisht, shkurtohen afatet minimale për të kryer procedurat e likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, zgjeron afatet për rritjen e kapitalit të shoqërisë aksionare me procedurën e kapitalit të autorizuar dhe me rritje të vlerës nominale të aksioneve, përcakton procedura për raste të dorëheqjes të organeve drejtuese të shoqërive etj.

Ky ligj rregullon pasojat e prishjes për shoqëritë që nuk kishin adoptuar njëkohësisht strukturën e tyre me kërkesat e ligjit nr. 9901, të vitit 2008, brenda afatit 3-vjeçar të kërkuara sipas neneve 230 dhe 231, pra siguron që me hyrjen në fuqi të këtij ligji asnjë vendim gjykatë nuk mund të vendosë prishjen e shoqërive që nuk kanë qenë të përshtatura me kërkesën e nenit 230 e vijues të tekstit origjinal të ligjit nr. 9901.

Këto janë pak a shumë disa nga pikat kryesore për projektligjin që ne paraqesim sot.

Ju faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Relatori, ju lutem!

Armando Subashi – Të bëj një pyetje unë, para se të...

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, bëj relatimin, pastaj bëj pyetje. Bëje në formë pyetjeje relatimin!

Armando Subashi – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ajo çka kemi sot përpara, pra, ndryshimet që kanë ardhur te ligji “Për shoqëritë tregtare”, do të thosha se është diçka shumë e rëndësishme, sepse sigurisht që ka të bëjë me një fushë shumë delikate të së drejtës në Shqipëri dhe përpos zhvillimit që ka marrë vitet e fundit ekonomia e tregut, në këtë fushë ne kemi dhe një mangësi, do të thosha, sepse në qoftë se degët e tjera të së drejtës në Shqipëri, duke filluar nga e drejta penale, e drejta

civile, e drejta administrative, e drejta familjare, dhe kështu me radhë, kanë pasur zhvillimin e vet historik edhe gjatë viteve të periudhës së komunizmit, përgjithësisht e drejta tregtare është një degë e re, e cila ka filluar zhvillimin e vet pas ndryshimeve, pra, mbas viteve '90-të dhe pa dyshim që ligjet bazë mbi të cilat operohet janë ligje që janë marrë mbi bazën e modeleve të shteteve perëndimore. Për shkak të një boshllëku të plotë që ekziston edhe në Shqipëri vështirësia në implementim në gjithë këto vite ka qenë e konsiderueshme, dhe këtu, në fakt, dua të sjell mendimin përgjithësisht edhe të komunitetit të juristëve, të gjyqtarëve, që ndoshta kur vjen momenti për ndryshime në ligjet që i përkasin kësaj fushe, duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Në fakt, nuk kemi kujt t'i referohemi tjetër për të marrë praktikë, për të marrë përvojë, veçse ndoshta të gjithë aktorëve dhe faktorëve që operojnë përditë në terren dhe që kanë të bëjnë me këto ligje.

Kështu që, nga kjo pikëpamje, që në fillim unë do të kisha një pyetje, që më pas mund të merrja edhe përgjigjen, që nuk e di sa janë konsultuar këto ndryshime me biznesin, me shoqatat e ndryshme që operojnë në këtë fushë, sepse, në fund të fundit, janë ata që hasen përditë me të gjitha problemet dhe pa dyshim mendimi i tyre do të ishte shumë herë më i vlefshëm sesa shumë diskutime teorike që mund të bëhen nëpër zyra, qoftë edhe përkthimi i direktivave të BE-së, të mos harrojmë që Europa ka përvojë disa qindra vjeçare në këtë fushë, ndërsa përvoja jonë është shumë e kufizuar. Kështu që do të ishte e pafalshme për ne nëse nuk do t'i referoheshim përvojës të paktën disavjeçare që biznesi ynë ka në këtë fushë.

Ligji "Për shoqëritë tregtare", siç e thashë, është një ligj i miratuar pas viteve '90-të, ka pasur një përmirësim të konsiderueshëm në vitin 2008, por gjithsesi, nga ajo çka ne jemi në kontakt përditë, mund të ketë nevojë për shumë ndryshime dhe përshtatje në raport me situatat e reja. Gjithsesi, unë pajtohem me ato që tha zëvendësministria në raport me risitë që sjell drafti, i cili përpiqet të rregullojë disa momente, disa mangësi që janë në ligjin ekzistues, përgjithësisht forcon pozitat e ortakëve në shoqëri dhe në një lloj kuptimi përcakton ose qartëson më mirë edhe përgjegjësitë në rast të dështimit të shoqërisë, sepse jo gjithmonë ka qenë e qartë kjo gjë edhe në shumë procese gjyqësore që janë zhvilluar, edhe në praktikë, deri ku është përgjegjësia e ortakut. Pra, ortakut përgjigjet mbi bazën e kontributit të vet në shoqëri, apo përgjigjet edhe mbi bazën e pasurisë që mund të ketë jashtë shoqërisë, dhe sigurisht, përcaktimi i saktë i këtij raporti është një moment shumë i rëndësishëm, sepse shumë herë këtu edhe është abuzuar me këtë raport.

U tha, dhe parashikohen edhe në projektligj, rastet e pavlefshmërisë, por në fakt ndoshta ka nevojë të saktësohet për të përcaktuar më mirë pavlefshmërinë absolute nga

pavlefshmëria relative, sepse edhe në këtë mes sigurisht që ky është një parim shumë i njohur i së drejtës, i cili edhe në të drejtën tregtare vlen të saktësohet dhe të precizohet saktë, nuk mund të bëjë përjashtim e drejta tregtare nga ky parim.

Momenti i administratorit në një shoqëri është shumë i rëndësishëm dhe përcaktimi saktë i këtij raporti brenda shoqërisë, si dhe rastet e dorëheqjes, shkarkimit, përgjegjësitë, veprimet abuzive të administratorit, veprime të cilat mund të jenë kryer në kundërshtim me vendimet e shoqërisë së ortakëve apo të asamblesë, ortakëve e kështu me radhë, sigurisht që janë momente, të cilat kanë nevojë të saktësohen. Në ligj janë bërë përpjekje në këtë drejtim, por ndoshta mund të jetë e nevojshme që të saktësohet diçka më shumë në këtë pikë, sepse nuk janë të pakta rastet kur administratorët abuzojnë me këtë gjë, shpeshherë me dhe pa dijeninë e ortakëve. Megjithëse rastet kanë qenë të ndryshme dhe ndonjëherë edhe vetë ortakët e një shoqërie janë munduar të luajnë me demokraci me padijënie të tyre ndaj veprimeve të administratorit. Ky është një moment shumë i rëndësishëm, sepse nuk ka të bëjë thjesht me përgjegjësinë e tij, por me raportet që krijon shoqëria me të tretët. Nëse këto raporte cenohen, atëherë ky është një proces zinxhir që përgjithësisht ndikon në të gjithë aktivitetin e shoqërive të tjera.

Nga kjo pikëpamje nuk dua të ndalem më shumë në këtë relativitet, sepse sot kemi shqyrtimin në parim. Përgjithësisht i mbështes të gjitha propozimet që kanë ardhur. Më vjen mirë që është përshtatur me direktivat e BE-së, por mendoj se ndoshta mund ta bëjmë edhe ne në komision, marrja e mendimit të komunitetit të biznesit do të ishte shumë e vlefshme në këtë pikë. Sigurisht, nuk duhet të mjaftohemi vetëm me këto ndryshime, pasi mund të ketë edhe nene apo institute të tjera që mund të kenë nevojë për përmirësime meqenëse ligji erdhi në parlament dhe nuk do të jetë mirë për ne që ta kalojmë në mënyrë kaq sipërfaqësore, sepse është një ligj shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut në Shqipëri.

Gjatë shqyrtimit nën për nën do të bëj edhe sugjerimet përkatëse.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zonja Paskali, fjala është për ju.

Brunilda Paskali – Është e vërtetë që ky ligj është shumë i rëndësishëm për shoqëritë tregtare, për klimën e biznesit dhe për sigurinë që ne u ofrojmë edhe investitorëve të huaj, jo vetëm thjesht për shoqëritë tregtare shqiptare.

E dimë që e drejta tregtare është një drejtim i ri i fushës juridike. Megjithatë, unë dua të theksoj se ne kemi bërë konsultime me shoqatat e biznesit. Në relacion thuhet se që nga muaji maj i vitit 2013 me asistencën e GIZ-it, pra gjermanët, kemi bërë takime për të marrë

prej tyre mendimet konkrete. Shumë ndryshime që janë bërë në këtë ligj janë bazuar në sugjerimet e shoqatave të biznesit dhe të shoqërive juridike, të cilat kanë hasur problematika kur kanë vajtur në gjykata. Ajo e ortakut ka qenë një nga gjërat që e kanë kërkuar shoqëritë e biznesit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit për shpjegimin!

Kush ka pyetje?

Zonja Hysi, keni fjalën.

Vasilika Hysi – Në dijeninë time, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Bankën Botërore po punon për ligjin e ri të falimentit. Sa po mbahet parasysh ky proces në propozimet që keni sjellë?

Fatmir Xhafaj – Zoti Sykja, fjala është për ju.

Bashkim Sykja – Siç u parashtrua nga zëvendësministrja, ky projektligj që po paraqesim sot këtu është punuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe gjatë shqyrtimit të tij ka pasur debate shumë të forta. Tani e mbrapa unë kam bindjen se edhe ligji i ri që po rishikohet nga Ministria e Drejtësisë gjen reflektim edhe në projektligjin “Për shoqëritë tregtare”, ka një harmonizim për këtë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka diskutime në parim.

Unë bashkohem me shqetësimin e relatorit dhe me kontekstin e pyetjes së koleges. Ky është një ligj më shumë se i rëndësishëm. Zëvendësministrja e tha drejt që ka interesa për shkak të fushës që prek, për shkak të mungesës së përvojës që kemi, për shkak të garancisë së nevojës që ka biznesi, por edhe për shkak të domosdoshmërisë për t’u dhënë më shumë garanci edhe investitorëve të huaj për njëlloj qëndrueshmërie në legjislacionin shqiptar.

Kjo kërkon që ne ta shqyrtojmë këtë projektligj me një vëmendje të veçantë, edhe për shkak të fushës dhe përgjegjësisë që kemi. Kështu që unë sugjeroj që çështjet e ngritura, relatori bashkë me këshilltarët, të shihen nga ministria, në mënyrë që të reflektohen. Por stafi i komisionit duhet që këtë projektligj sot me urgjencë ta japë për konsultim me seksionet tregtare të gjykatave kryesore në vend, sepse është shumë e rëndësishme. Ministria nga ana tjetër të na sjellë, që të na e lehtësojë punën, rekomandimet konkrete që kanë bërë organizatat që operojnë në fushën e biznesit dhe shkallën e marrjes së tyre në konsideratë, në mënyrë që

ne të mos detyrohemi të bëjmë një proces të dytë për këtë gjë. Në përfundim të gjithë këtij procesi konsultimi të domosdoshëm të hyjmë në diskutimin nen për nen.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në parim, për t'i hapur rrugë shqyrtimit nen për nen.

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë që ishin të pranishëm! Gjithë të mirat dhe punë të mbarë! Por mos e quani të përfunduar këtu, sepse për ministrinë në draftet e mëparshme kemi pasur disa shqetësime në lidhje me cilësinë, kështu që duhet të ulemi të punojmë për këtë gjë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROCESVERBAL

Datë 10.09.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë – Hercegovinës, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Mark Frroku, Gjovalin Bzheta, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

1. Ramadan Çaço – drejtor në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
2. Danja Sinanaj – juriste, DSIK

Fatmir Xhafaj – Atëherë, pika e dytë e rendit të ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

Për të bërë një paraqitje, një prezantim të projektit, janë këtu zoti Ramadan Çaço, drejtor në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, zonja Danja Sinanaj, juriste në këtë institucion.

Po, zoti Çaço, besoj se do të bëni një përmbledhje të shkurtër.

Ramadan Çaço – Përsëritje! Marrëveshja për sigurimin e informacionit të klasifikuar, e lidhur midis NATO-s dhe Republikës së Shqipërisë, si me të gjitha vendet anëtare të saj, midis të tjerave parashikon që palët të mbrojnë informacione të klasifikuara të NATO-s, të klasifikuara prej saj sipas standardeve të kërkuara. Palët nuk do ta përdorin informacionin e klasifikuar të marrë nga organizata, për qëllime të tjera, përveç qëllimit të parashikuar në marrëveshje. Palët nuk do ta transferojnë informacionin e klasifikuar të NATO-s te një palë e tretë, por kjo marrëveshje e lidhur nuk i pengon palët, që në mënyrë bilaterale, shtetet anëtare, të lidhin marrëveshje me njëra-tjetrën për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Së dyti, dokumenti CM 200249, i rishikuar, i NATO-s, i cili flet për principet bazë dhe standardet minimum të sigurisë, në kapitullin “Përgjegjësitë e sigurisë” përcakton se çdo vend anëtar i NATO-s detyrohet të krijojë një autoritet të sigurisë kombëtare për çështje të sigurisë së informacionit.

Detyrat e këtij autoriteti janë mbikëqyrja e zbatimit të masave të sigurisë së informacionit të klasifikuar, të garantojë që inspektimet për sigurinë e informacionit të bëhen në mënyrë periodike, të raportojë ëpr incidentet e sigurisë së informacionit dhe detyra të tjera.

Në nenin 24 të ligjit...

(Diskutime pa mikrofon)

Në këtë kuadër, bazuar në sa më sipër dhe në një rekomandim të zyrës së NATO-s për sigurinë, vendet anëtare inspirohen, janë në marrëveshje kuadër...

(Diskutime pa mikrofon)

Në këtë kuadër vjen për shqyrtim dhe miratim para jush kjo marrëveshje.

Në nenin 1 të marrëveshjes janë përkufizimet, ekuivalencat...

Fatmir Xhafaj – Mos u lodh se i kemi këtu përpara, zotëri! Mos u lodh! Je i qartë. Është marrëveshje tip, e kemi parë, shtatë marrëveshje të kësaj natyre i njoh unë, që kanë ardhur këtu. Keni ndryshuar vetëm një gjë: nga Kroaci e keni bërë Bosnjë. Në rregull! Dakord!

Ka pyetje? E shikon që s'ka pyetje, sepse është një gjë që...

(Diskutime pa mikrofon)

Ka pyetje?

Po, relatori. Qëndrimi i komisionit?

Vexhi Muçmataj – Faleminderit, zoti kryetar! Marrëveshja për ratifikimin ose projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë, Këshillit të Ministrave, të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, “Për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”, vjen i propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, e merr në shqyrtim këtë projektligj, bazuar në nenet 121, 122 dhe 123 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kreu i dytë “Për marrëveshjet ndërkombëtare”.

Natyrisht, objekti i kësaj marrëveshjeje është të mbrojë e të sigurojë palët, që informacioni i klasifikuar i shkëmbyer në kuadër të bashkëpunimeve në fusha të ndryshme, të mbrohet në përputhje me standardet e sigurisë, të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje krijon bazën ligjore, që ministritë dhe institucionet shtetërore të vendit tonë të lidhin marrëveshje me homologët e tyre boshnjakë, në të cilat përfshihet shkëmbimi i informacionit të klasifikuar.

Nga hyrja në fuqi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje nuk ka efekte financiare. Nga pikëpamja e kuadrit ligjor, pra nga pikëpamja e aspektit ligjor, marrëveshja respekton Kushtetutën. Nga pikëpamja procedurale ajo është në përputhje me kërkesat e rregullores. Prandaj, duke vlerësuar rëndësinë e marrëveshjes për vendin tonë, i propozoj komisionit që ta miratojmë dhe ta kalojmë për votim në seancë plenare.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Muçmata!

Ky është qëndrimi i relatorit, që besoj është edhe qëndrimi i komisionit. Ka diskutime? Nuk ka. Për detajet, besoj se do ta shikojë Komisioni i Sigurisë. Nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore marrëveshja, siç tha relatori, duhet të marrë vlerësimin pozitiv dhe mbështetjen e komisionit, kështu që e votojmë. Dakord në parim?

Dakord.

Neni 1. Dakord!

Neni 2. Dakord!

Në tërësi?

Dakord!

Faleminderit! Miratohet. Detajet teknike i shihni në Komisionin e Sigurisë.

Për sot e mbyllim këtu. Ditë të mbarë e gjithë të mirat! Mirupafshim!